Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/20
Datë: 20.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke marrë parasysh Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2.0. për Kosovën, Objektivi 1 i Planit të Veprimit (Sistemi rregullativ lehtësues) të miratuar në Qeveri me vendimin nr. 03/121 të datës 21.12.2016, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzuesi për Hartimin e Koncept Dokumenteve.
2. Obligohen të gjitha strukturat në kuadër të Qendrës së Qeverisë dhe në ministrinë e linjës që të përdorin Testin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (Testi i NVM) dhe Modelin e Kostimit Standard (MKS) për Draft Koncept Dokumentet përkatëse që adresojnë çështjet e funksionimit të bizneseve.
3. Obligohen të gjitha strukturat në kuadër të Qendrës së Qeverisë dhe në ministrinë e linjës që të përdorin Vlerësimin e Ndikimit Gjinor dhe Analizën e Barazisë Sociale për Koncept Dokumentet përkatëse.
4. Qeveria ia atribuon përgjegjësinë Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së për nxjerrjen e Manualit për zhvillimin e Koncept Dokumenteve.
5. Sekretariati Koordinues i Qeverisë në kuadër të ZKM-së është përgjegjës për përditësimin e Manualit për hartimin e Koncept Dokumenteve në përputhje me kërkesat dhe njohuritë për analizën e politikave sa herë që konsiderohet e nevojshme, me qëllim të përmirësimit të procesit të hartimit të politikave.
6. Obligohen të gjitha strukturat në kuadër të Qendrës së Qeverisë dhe në ministrinë e linjës për zbatimin e Udhëzuesit për Hartimin e Koncept Dokumenteve nga muaji Janar 2018.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/20
Datë: 20.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Fushën e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe për Deklarimin, Prejardhjen e Pasurisë.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 22/20
Datë: 20.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Përafrimin e Kornizës Ligjore Vendore për Sanksionet Ndërkombëtare me qëllim të harmonizimit me Standardet Ndërkombëtare (Plotësim/Ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare).
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 23/20
Datë: 20.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet si e bazuar kërkesa e Shoqatës së Bankave të Kosovës, për të drejtën e bartjes së qirambajtjes për 99 vite.
2. Obligohet Agjencia Kadastrale e Kosovës që të bëjë regjistrimin e të drejtës së qirambajtjes për 99 vite, për të gjitha paluajtshmëritë e privatizuara përmes Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 24/20
Datë: 20.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 39 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, të nenit 53 dhe 56 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Anulohet Vendimi Përfundimtar Nr. 09/154 i datës 30.08.2017 për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit për zgjerimin e mihjes sipërfaqësore për eksploatim të thëngjillit për prodhim të energjisë elektrike për nevoja të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK - Sh.A), Zonat Kadastrale: Hade dhe Shipitullë, Komuna Obiliq (i shpallur në Gazetën Zyrtare të Kosovës Nr. 24 datë 31.08.2017), sipas tabelave të bashkëngjitura këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përmendura në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK - Sh.A), dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.


Kryeministër i Republikës së Kosovë

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 25/20
Datë: 20.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe të nenit 53 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet në tërësi sipas detyrës zyrtare, Vendimi Nr. 05/71, datë 22.01.2016, që ndërlidhet me shpalljen Zonë e Veçantë e Mbrojtur hapësira në sipërfaqe prej 4.280 ha, e emërtuar si "Zonë e Gadimës" e cila shtrihet në territorin e Komunës së Lipjanit.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 26/20
Datë: 20.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane për Investime (BEI), për financimin e projektit për autostradën Kijevë - Zahaq.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave që të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 27/20
Datë: 20.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për t'i rekomanduar Presidentit të Republikës së Kosovës nga Qeveria e Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) për financimin e projektit për Përmirësimin e Rrjetit të Transmisionit, faza e VI.
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 28/20
Datë: 20.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për t'i rekomanduar Presidentit të Republikës së Kosovës nga Qeveria e Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) për financimin e projektit për Përmirësimin e Rrjetit të Transmisionit, faza e VII.
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 29/20
Datë: 20.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 49 paragrafi 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet (GZ Nr. 80/2010), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale e datës 08.12.2017 nr. prot. 2509, për konfirmimin e interesit të përgjithshëm të shfrytëzimit të resurseve minerale nga Trepça Sh.A.
2. Konfirmimi i interesit të përgjithshëm nga pika 1. e këtij vendimi, bëhet me qëllim të krijimit të bazës juridike për lëshimin e licencës nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, konform Ligjit për Minierat dhe Mineralet, për ushtrimin e aktiviteteve përkatëse të saj në interes të përgjithshëm publik, duke pasur për bazë aspektin ekonomik dhe social të zhvillimit të Trepça Sh.A.
3. Obligohet Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Trepça Sh.A, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 30/20
Datë: 20.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet emri i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës Radoniqi Sh.A Gjakovë, në emrin "Kompania Rajonale e Ujësjetës Gjakova Sh.A, Gjakovë.
2. Kompania Rajonale e Ujësjetës Gjakova Sh.A Gjakovë, autorizohet që të veprojë në emër të ri të kompanisë sipas këtij vendimi dhe obligohet të ndermarrë te gjitha veprimet e ligjshme duke përfshirë edhe ndryshimin në statut dhe ndryshimin në regjistrin e regjistrimit te kompanise sias Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
3. Kompania Rajonale e Ujësjetës Gjakova Sh.A Gjakovë, të drejtat dhe detyrimet e saj do t'i ushtrojë dhe do ë prezantohet me emrin e ri në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Kompania Rajonale e Ujësjetës Gjakova Sh.A Gjakovë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 31/20
Datë: 20.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Vjetor i Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2015 dhe 2016.
2. Raportin nga pika 1. e këtij vendimi obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që ta dërgojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 32/20
Datë: 20.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, me qëllim të konsolidimit të punës së dy Komisioneve Ndërministrore, të miratuara me vendim të Qeverisë për themelimin e Komisionit për Kthim me numër 05/29 të datës 15.05.2015 dhe vendimin për themelimin e Komisionit për Çështje të Komuniteteve nr. 05/53 të datës 16.10.2015, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për formimin e Komisionit Ndërministror për Kthim dhe Çështjet e komuniteteve:
 - 1.1. Dalibor Jevtić - Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim Kryesues;
 - 1.2. Ministri i Ministrisë së Drejtësisë anëtar;
 - 1.3. Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme anëtar;
 - 1.4. Ministri i Ministrisë së Pushtetit Lokal anëtar;
 - 1.5. Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor anëtar;
 - 1.6. Ministri i Ministrisë së Administratës Publike anëtar;
 - 1.7. Ministri i Ministrisë së Financave anëtar;
 - 1.8. Ministri i Ministrisë së Bujqësisë anëtar;
 - 1.9. Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenes Sociale anëtar;
 - 1.10. Ministri i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal anëtar.
2. Ky Komision Ndërministror për Kthim dhe Çështjet e Komuniteteve, do të ketë mandatin për shqyrtimin e të gjitha çështjeve që lidhen me procesin e kthimit të personave të zhvendosur dhe stabilizimin e komuniteteve, si dhe të krijojë një koordinim më të mirë institucional në punën dhe zbatimin e vendimeve.
3. Anëtarët e Komisionit Ndërministror për Kthim dhe Çështjet e Komuniteteve, janë të obliguar t'a zbatojnë këtë vendim në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Planit të Punës së Qeverisë, ligjeve të aplikueshme dhe Strategjisë për Komunitete dhe Kthim 2014-2018, me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve të qëndrueshme për kthim dhe çështjet e komuniteteve, duke përfshirë:
 - 3.1. E drejta për kthim;
 - 3.2. Krijimi i besimit dhe dialogut ndërmjet komunave;
 - 3.3. Zbatimi i politikave në nivel qendror dhe komunal, duke përfshirë mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të kthyerve;

- 3.4. Të drejtat e pronësisë, dokumentacioni personal, menaxhimi i të dhënave, siguria, dialogu dhe riintegrimi dhe planifikimi i zgjidhjeve, si dhe
 - 3.5. Marrja e aktiviteteve të tjera të nevojshme në bazë të ligjeve të aplikueshme për ta bërë procesin e kthimit më të qëndrueshëm dhe më të suksesshëm.
4. Komisioni Ndërmintor për Kthim dhe Çështjet e Komuniteteve do të hartojë një plan për funksionimin e punës së tij, ndërsa Kryesuesi i Grupit të Punës do të paraqes aktet ligjore lidhur me funksionimin e grupit.
 5. Sekretari i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim do të shërbejë si sekretariat teknik i Komisionit Ndërmintor për Kthim dhe Çështjet e Komuniteteve.
 6. Kryetari i Komisionit Ndërmintor është përgjegjës për mbajtjen e takimeve.
 7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, anulohet vendimi i Qeverisë nr. 05/29 të datës 15.05.2015 dhe vendimi i Qeverisë nr. 05/53 të datës 16.10.2015.
 8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 33/20
Datë: 20.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për aprovimin e kontratave komerciale për Termocentralin Kosova e Re nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës si vijon;
 - a. Marrëveshja për Blerje të Energjisë
 - b. Marrëveshja për Furnizim me Linjit
 - c. Marrëveshja për Transferim të Lokacionit
 - d. Marrëveshja për Implementim
 - e. Marrëveshja për Sponzorizim
 - f. Marrëveshja për Kycje
 - g. Marrëveshja për Furnizim me Ujë
 - h. Marrëveshja për Deponim të Hirit dhe Gipsit
2. Obligohet Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik në cilësinë e kryesuesit të KDP-së me vendimin e datës nr. 08/17 të datës 01/06/2011, për nënshkrim të kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë